



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1082/5 prot.

Datë 04.05.2026

**V E N D I M**

**Nr.580/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.05.2026 me

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “NET-GROUP” Shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-77318-02-24-2026, me objekt “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, me fond limit 14,443,130.28 (katermbedhjete milion e katerqind e dyzet e tre mije e njeqind e tridhjete pike njezet e tete) Lek pa Tvsh.

**Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njezet e gjashte mije e nenteqind e pesedhjete e tre pike gjashtedhjete e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

**Ankimues:**

OE “NET-GROUP” Shpk, me NIPT L72023002P, me adresa: Rruga Vorpsset , pas restorant Piazza , ZK 8350, Nr. Pasurie 6/187/N2, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Lezhë

Adresa: L. Skenderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**I****Vëren:***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 25.02.2026, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit **Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njezet e gjashte mije e nenteqind e pesedhete e tre pike gjashtedhete e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 12.03.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 24.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- "TAULANT" SHPK,	7.900.000 I Skualifikuar
2- BOE “ANGERBA” Shpk, & “LENIING” Shpk,	8,160,410 I Skualifikuar
3- BOE “Bersant Ylli” P/F, & “XH & MILER” Shpk,	44,449.65 I Skualifikuar
4- “BN PROJECT” Shpk,	pa oferte ekonomike I Skualifikuar
5- “ERALD-G” Shpk,	7,350,000 I Skualifikuar
6- BOE “FTA Studio” Shpk, & “ARKIMADE” Shpk,	8,300,000 I Kualifikuar
7- BOE “HTS COMPANY” Shpk, & “HE & SK 11” Shpk,	8,077,145.01 I Skualifikuar
8- “InfraKonsult” Shpk,	7,494,000 I Skualifikuar
<b>9- “NET-GROUP” Shpk,</b>	<b>7,505,412,05 I kualifikuar</b>
10- “NOVATECH STUDIO” Shpk,	7,462,989.54 I Skualifikuar
11- BOE “Palma Construction” Shpk, & “ProStruct” Shpk,	8,162,600 I Kualifikuar
12- BOE “PRO GREEN” Shpk, & “SELAS” Shpk,	8,160,415.55 I Kualifikuar
13-BOE “ZENIT&CO” Shpk, & “DERBIE” Shpk,	8,200,000 I Skualifikuar

II.4. Referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontaktor me shërbim postar, me shkresën përcjellëse me nr. 4481/3 prot, datë 10.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1082/2 prot., datë 14.04.2026, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, sipas së cilës “.....Referuar dokumentacionit të administruar pranë AK-së rezulton se, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është bërë vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, **ku paraprakisht oferta e OE “Net-Group” shpk është kualifikuar.** Në vijim, bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nga ana e autoritetit kontraktor i është kërkuar OE “Net-Group” shpk dokrëzimi i dokumentacionit fizik.

II.5. Referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontaktor me shërbim postar, me shkresën përcjellëse me nr. 4481/3 prot, datë 10.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1082/2 prot., datë 14.04.2026, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, sipas së cilës .... “pas dorëzimit të dokumentacionit pranë Bashkisë Lezhë nga OE “Net-Group” shpk me anë të shkresës me nr. 121 prot., datë 26.03.2026, protokolluar pranë Bashkisë Lezhë me nr. 3931 prot., hyrës, datë 26.03.2026, vërehet se, nga ana e KVO-së është bërë vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “Net-

Group” shpk, ku rezulton se, .....nuk plotëson pikën 2.2.1 Kjo pikë e kritereve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta të kualifikimit të plotësuarra më sipër. (Shtojcat). Si dhe pikën 2.3.4.....

.....Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK-së rezulton OE-së nuk ka paraqitur për asnjë nga stafi teknik “Deklaratat mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit” sipas shtojcës 5, të DST”.

II.6. Në datën 01.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e ri-vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- "TAULANT" SHPK,	7.900.000 I Skualifikuar
2- BOE “ANGERBA” Shpk, & “LENIING” Shpk,	8,160,410 I Skualifikuar
3- BOE “Bersant Ylli” P/F, & “XH & MILER” Shpk,	44,449.65 I Skualifikuar
4- “BN PROJECT” Shpk,	pa oferte ekonomike I Skualifikuar
5- “ERALD-G” Shpk,	7,350,000 I Skualifikuar
6- BOE “FTA Studio” Shpk, & “ARKIMADE” Shpk,	8,300,000 I Kualifikuar
7- BOE “HTS COMPANY” Shpk, & “HE & SK 11” Shpk,	8,077,145.01 I Skualifikuar
8- “InfraKonsult” Shpk,	7,494,000 I Skualifikuar
<b>9- “NET-GROUP” Shpk,</b>	<b>7,505,412,05 I Skualifikuar</b>
10-“NOVATECH STUDIO” Shpk,	7,462,989.54 I Skualifikuar
11- BOE “Palma Construction” Shpk, & “ProStruct” Shpk,	8,162,600 I Kualifikuar
12- BOE “PRO GREEN” Shpk, & “SELAS” Shpk,	8,160,415.55 I Kualifikuar
13-BOE “ZENIT&CO” Shpk, & “DERBIE” Shpk,	8,200,000 I Skualifikuar

II.7. Në datën 02.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Njoftimin Paraprak i OE të suksesshme në MK”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 24, datë 07.04.2026.

II.8. Në datën 08.04.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/6502 dhe me nr. 1082/2026 prot, datë 09.04.2026 e OE “NET-GROUP” Shpk, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “NET-GROUP” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e

zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1082/1 prot., datë 09.04.2026.

II.10. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 4481/3 prot, datë 10.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1082/2 prot., datë 14.04.2026, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e formularit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, i cili është **i refuzuar**.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NET GROUP” SHPK mbi skualifikimin e tij nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave me argumentimin se: “.....Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE nuk plotëson piken 2.1.1 “Kjo pikë e kritereve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuara më sipër. (Shtojcat)”, si dhe piken 2.3.4 ku parashikohet se: “Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtues teknik).....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9, pika 2.1. “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*2.1.1 Kjo pikë e kritereve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuara më sipër. (Shtojcat).*

*2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtues teknik) personeli si më poshtë:*

- |                                 |                |
|---------------------------------|----------------|
| <i>a. Inxhinier Ndërtimi</i>    | <b>1 (nje)</b> |
| <i>b. Inxhinier Hidroteknik</i> | <b>1 (nje)</b> |
| <i>c. Inxhinier Mjedisi</i>     | <b>1 (nje)</b> |
| <i>d. Inxhinier Gjeodet</i>     | <b>1 (nje)</b> |

*Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Nentor 2025 – Janar 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatëse. Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatëse te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Net-Group” SHPK, për përmbushjen e kriterit 2.2.1 dhe 2.3.4, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion në SPE dhe dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:

-Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit të OE “Net-Group” shpk, ku në seksionin B “Deklaratë” Për disponimn e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohën)

“Deklaratë” Për disponimn e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohën)

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <p>Mbi 4 (katër) punonjës të regjistruar në total për periudhën e kërkuar në DST, ku përfshihet dhe stafi i angazhuar në këtë procedurë</p> <hr/> <p><u>Profili i punonjësve</u></p> <p>Stafi kryesor që do të angazhohet për këtë procedurë, licensuar sipas kategorive që kërkohen në DST:</p> <p>██████████ – Inxhinier Ndërtimi</p> <p>██████████ – Inxhinier Hidroteknik</p> <p>██████████ – Inxhinier Mjedisi, Ekspert i Certifikuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ekspert Zjarrfikës</p> <p>██████████ – Inxhinier Gjeodet</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <p>Pajisje Gjeodezike ██████████ i90</p>



-DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" të OE “net-Group” shpk për muajin nëntor 2025-Dhjetor 2025 dhe Janar 2026; Me drejtues teknik Z. I.K-Ing. Ndërtimi, Z. K.N-Ing. Hidroteknik, Z. A.G

-Ing. Mjedis, Znj.Sh.C-Ing. Gjeodet të cilët figurojnë në këto listpagesa për periudhën nëntor 2025-janar 2026;

-Licenca MK.3101/22 Për mbikëqyerjen dhe kolaudim të punimeve të zbatimit për shoqërinë “Net-Group” shpk të regjistruar në regjistrin profesional që nga data 25.02.2026, me vlefshmëri deri me 26.07.2027. Me drejtues teknik Z. I.K-Ing. Ndërtimi, Z. K.N-Ing. Hidroteknik, Z. A.G –Ing. Mjedis, Znj.Sh.C-Ing. Gjeodet.

-Dokumentacioni teknik për Z. I.K-Ing. Ndërtimi, Diplomë Nr. 3962-B lëshuar nga FIN, Licencë K.1008/4 në projektim, Licencë MK.1663/6 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Z. I.K, me Nr. Rep.3798, Nr. Kol.2274, datë 11.12.2023, në pozicionin inxhinier ndërtimi-Drejtues teknik.

-Dokumentacioni teknik për Z. K.N-Ing. Hidroteknik, Diplomë Nr. 234-B lëshuar nga FIN, Licencë K.3500/2 në projektim, Licencë MK.4485/1 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Z. K.N, me Nr. Rep.306, Nr. Kol.154, datë 20.01.2025, në pozicionin inxhinier Hidroteknik -Drejtues teknik.

-Dokumentacioni teknik për Z. A.G –Ing. Mjedis, Diplomë Nr. 3177 lëshuar nga FIN, Licencë M.1261/2 në projektim, Licencë MK.4411 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Z. A.G, me Nr. Rep.3842, Nr. Kol.1914, datë 20.08.2024, në pozicionin inxhinier Mjedisi-Drejtues teknik.

-Dokumentacioni teknik për Znj.Sh.C-Ing. Gjeodet, Diplomë Nr. 6199.B lëshuar nga UT, Licencë T.1268 në projektim, Licencë MK.3117 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Znj.Sh.C, me Nr. Rep.2402, Nr. Kol.712, datë 05.08.2022, në pozicionin inxhinier Gjeodet -Drejtues teknik.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin*

*mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

III.1.5. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin

dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Referuar hartimit të kriterëve teknike, konkretisht kapacitetit profesional të ofertuesëve, pikat 2.1.1 dhe 2.3.4, ku autoriteti kontraktor ka kërkuar që për mbushjen e tyre të dorëzohen shtojca nr. 10 (Formulari përmbledhës i vetdeklarimit). Gjithashtu, për pikën 2.3.4 në lidhje me stafin e drejtuesëve teknik të licencës, për të cilët duhet dorëzuar diploma, licenca profesionale personale, kontrata e punës dhe të figurojnë në listpagesat e priudhës nëntor 2025-dhjetor 2025 dhe Janar 2026. Duke iu referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si dhe trajtimit të formularit të ankesës nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, sipas së cilëve ofertuesi “Net-Group” shpk nuk përmbush pikat 2.1.1 dhe 2.3.4, Komisioni i Prokurimit Publik, mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e ofertës teknike të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), i cituar edhe në pikën III.1.2. ku sipas së cilit kemi:

*-Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit të OE “Net-Group” shpk, ku në seksionin B “Deklaratë” Për disponimn e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohën)*

*-DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" të OE “net-Group” shpk për muajin nëntor 2025-Dhjetor 2025 dhe Janar 2026; Me drejtues teknik Z. I.K.-Ing. Ndërtimi, Z. K.-Ing. Hidroteknik, Z. A.G –Ing. Mjedis, Znj.Sh.C-Ing. Gjeodet të cilët fidojnë në këto listpagesa për periudhën nëntor 2025-janar 2026;*

*-Licenca MK.3101/22 Për mbikëqyerjen dhe kolaudim të punimeve të zbatimit për shoqërinë “Net-Group” shpk të regjistruar në regjistrin profesional që nga data 25.02.2026, me vlefshmëri deri me 26.07.2027. Me drejtues teknik Z. I.K-Ing. Ndërtimi, Z. K.N-Ing. Hidroteknik, Z. A.G – Ing. Mjedis, Znj.Sh.C-Ing. Gjeodet.*

*-Dokumentacioni teknik për Z. I.K-Ing. Ndërtimi, Diplomë Nr. 3962-B lëshuar nga FIN, Licencë K.1008/4 në projektim, Licencë MK.1663/6 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Z. I.K, me Nr. Rep.3798, Nr. Kol.2274, datë 11.12.2023, në pozicionin inxhinier ndërtimi-Drejtues teknik.*

*-Dokumentacioni teknik për Z. K.N-Ing. Hidroteknik, Diplomë Nr. 234-B lëshuar nga FIN, Licencë K.3500/2 në projektim, Licencë MK.4485/1 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Z. K.N, me Nr. Rep.306, Nr. Kol.154, datë 20.01.2025, në pozicionin inxhinier Hidroteknik -Drejtues teknik.*

*-Dokumentacioni teknik për Z. A.G –Ing. Mjedis, Diplomë Nr. 3177 lëshuar nga FIN, Licencë M.1261/2 në projektim, Licencë MK.4411 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Z. A.G, me Nr. Rep.3842, Nr. Kol.1914, datë 20.08.2024, në pozicionin inxhinier Mjedis-Drejtues teknik.*

*-Dokumentacioni teknik për Znj.Sh.C-Ing. Gjeodet, Diplomë Nr. 6199.B lëshuar nga UT, Licencë T.1268 në projektim, Licencë MK.3117 në mbikëqyerje dhe kolaudim, Cv, librezë pune, kontratë pune lidhur midis shoqërisë “Net-Group” shpk dhe Znj. Sh.C, me Nr. Rep.2402, Nr. Kol.712, datë 05.08.2022, në pozicionin inxhinier Gjeodet -Drejtues teknik.*

KPP konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjithë dokumnetacionit teknik të ankimues, rezulton se, operatori ekonomik “Net-Group” SHPK me dokumentacionin e paraqitur përmbush kriteret e kapacitetit teknik pikat 2.1.1 dhe 2.3.4 të DST, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë, i cili në fazën procedurale online përmbushet me formularin përmbledhës së vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Konkretisht, për plotësimin e këtyre kapaciteteve ka dorëzuar shtojcën nr.10 të Formularit të Vetdeklarimit të OE “Net-Gruop” shpk si dhe gjithë dokumentacionin teknik për pikën 2.3.4 të stafit drejtues teknik në licencë si diploma, licenca profesionale personale për secilin profil (ndërtim-hidroteknik-mjedisi-gjeodet), kontrata e punës dhe të figurojnë në listpagesat e periudhës nëntor 2025-dhjeotor 2025 dhe Janar 2026. Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik “Net-Group” SHPK. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron kapacitetin profesional teknik për stafin e drejtuesit teknk në licencë. Pra, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kapacitetit teknik, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Net-Group” SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit përmbush kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi operatorit ekonomik ankimues “NET GROUP” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NET GROUP” SHPK mbi skualifikimin e tij nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave me argumentimin se: “.....Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK-së rezulton OE-së nuk ka paraqitur për asnjë nga stafi teknik “Deklaratat mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit” sipas shtojcës 5, të DST .....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 5 “Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

#### **Shtojca 5.**

*(<sup>1</sup>Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik)*

---

<sup>1</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

## DEKLARATË

### Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, Deklaroj se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

---

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

III.2.2. Neni 3 i LPP-së "Parime të përgjithshme" parashikon shprehimisht se: "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën".

III.2.3. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar përcaktohet se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike,

financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga

operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të OE "Net-Group" SHPK me arsyetimin se: "...OE nuk ka paraqitur Shtojcën 5 - Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit", si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e posaçme nga ana e autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të paraqesin një "Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit sipas shtojcës 5 të dokumentave të tenderit. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit duhet të paraqesin në këtë fazë të procedurës një dokument Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit sipas shtojcës 5 të dokumentave të tenderit. Ndërsa, në anën tjetër duke ju referuar procesverbalit të hartimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim pika 2.3.4 e DST, autoriteti kontraktor e ka lidhur në mënyrë të përgjithshme me nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar ,.....[ **Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendimin Nr. 943, Datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, Datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik per afatin e kerkuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryeje*

*sherbimin ne kohe dhe cilesi....]*, pa ju drejtuar urdhërimeve të shkronjës dhe pikës përkatëse të kësaj dispozite konkretisht shkronjës “d” të pikës 4 të saj në të cilin përcaktohet në mënyrë eksplicite se *“Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë 12 ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”* Gjithashtu autoriteti kontraktor arsyen e skualifikimit por edhe kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës e ka lidhur me kontrata shërbimi të natyrës intelektuale dhe jo me kontratat e shërbimit në kuptimin klasik të tyre në të cilat mbizotërojnë aspekte fizike të veprimtarisë dhe që nuk kërkojnë ekspertizë të posacme. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe secifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ofertues është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik.

Sa më sipër, pretendimi operatorit ekonomik ankimues “NET GROUP” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Net Group” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-77318-02-24-2026, me objekt “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, me fond limit 14,443,130.28 (katermbedhete milion e katerqind e dyzet e tre mije e njeqind e tridhete pike njezet e tete) Lek pa Tvsh. **Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njezet e gjashte mije e nenteqind e

pesedhjte e tre pike gjashtedhjte e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Net Group” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “NET GROUP” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

